



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2021:213395

Datë: 28.02.2024

Numri i dokumentit: 05385783

KPPP.nr.999/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbarimore të kreditorit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, Kalabri, rr. “Rexhep Krasniqi”, kundër debitorit “Kospred” sh.p.k., me NUI:810015778, me seli në Fushë Kosovë Rr.”Nëna Terezë”, të cilën sipas autorizimit përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Vokshi & Lata” me seli në Prishtinë rruga “B”, Hy.C15/10, Mati 1, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.864/2021 të datës 01.07.2021, lëshuar nga Përmbaruesi Privat Enis Hoxha, me seli në Prizren, jashtë seancës, me datë 28.02.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Kospred” sh.p.k., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.864/2021 i datës 01.07.2021, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Enis Hoxha.
- II. MBETET NË FUQI Urdhrit Përmbarimor P.nr.864/2021 i datës 01.07.2021, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Enis Hoxha.

**A r s y e t i m**

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Dogana e Kosovës, ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.864/21 të datës 01.07.2021, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit Aktvendim i Doganës së Kosovës- Sektori për Kundërvajtje Doganore nr. 03.1.7-2019-1831 i datës 16.10.2020 i formës së prerë prej datës 22.11.2020 dhe i ekzekutueshëm prej datës 22.12.2020, me të cilën debitori është obliguar që kreditorit në emër të gjobës t’ia paguaj shumën prej 10,000.00 euro si dhe shpenzimet e procedurës, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm, me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë

bankare, si dhe me sekuestrimin e sendeve të luajshme dhe të paluajshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim ndaj Urdhrit Përmbarimor duke theksuar se këtë prapësim e bazon në nenin 71 par.1.2 të LPP-së, dokumenti në bazë të cilit është marrë urdhri përmbarues e ka humbur efektin juridik pasi që debitori ka ushtruar kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të aktit administrativ për të cilën Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative- Divizioni Fiskal me aktvendimin A.nr.1922/20 të datës 11.03.2021, ka vendosur që të shtyjë ekzekutimin e vendimit deri në vendosje të konfliktit administrativ me vendim përfundimtar të gjykatës. Tutje ka theksuar se kreditori ka paraqitur kallëzim penal kundër personit përgjegjës të debitorit duke pretenduar se gabimisht është deklaruar kodi doganor dhe duke pretenduar se ka kryer veprën penale shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore ose tarifave akcizore. I ka propozuar gjykatës që të pranohet prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri përmbarimor dhe të obligohet kreditori për kompensimin e shpenzimeve për përpilimin e prapësimit.

Kreditori me përgjigjen në prapësim i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit, duke theksuar se debitori nuk ka paraqitur asnjë kundërshtim esencial dhe si i tillë prapësimi i tij është pa bazë ligjore dhe se detyrimet nga aktvendimi me të cilin është obliguar debitori nuk i ka paguar obligimet ndaj kreditorit. Ka shtuar se propozimi për përmbarim i plotëson të gjitha kushtet e parapara dhe si i tillë është i përshtatshëm për përmbarim ndaj debitorit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht Vendimin Nr. 03.1.7-2019-1831 i datës 16.10.2020, në bazë të së cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti

se i njëjti, konform nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata gjeti se vendimi i lartcekur i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi Nr.03.1.7-2019-1831 i datës 16.10.2020, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbarueshmërinë e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase Aktvendimi Nr.03.1.7-2019-1831 i datës 16.10.2020, i nxjerrë nga Dogana e Kosovës- Sektori për Kundërvajtje Doganore, është bërë i formës së prerë me datë 22.11.2020 dhe i ekzekutueshëm me datë 22.12.2020.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se lidhur me këtë çështje ka iniciuar konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, dhe gjeti se Aktvendimi A.nr.1922/20 i datës 11.03.2021 ka shtyrë ekzekutimin e vendimit të doganës së Kosovës me numër 01.3.2.2/10.46/10498 i datës 05.10.2020, e që në rastin konkret dokument përmbarimor nuk është vendimi me të cilin është shtyrë ekzekutimi i vendimit por është vendimi me numër Nr. 03.1.7-2019-1831 i datës 21.10.2020 përbën dokument përmbarimor konform nenit 24 par.3 të LPP-së, me të cilën përcaktohet se *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë.”*, dhe bazuar në dispozitën e nenit 22 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, me të cilën është përcaktuar se: *“Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe”*, rezulton se paraqitja e padisë nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e aktit administrativ në procedurën përmbarimore dhe si rrjedhojë nuk e ndalon përmbarimin.

Gjykata po ashtu vlerësoj pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, dhe erdhi në përfundim se pretendimet e tilla janë pa mbështetje ligjore, ngase në këtë procedurë, kjo gjykatë

nuk mund të lëshohet në vlerësimin tjera të paraqitura nga debitori, sepse të njëjtat pretendim mund të realizohet në ndonjë procedurë tjetër eventuale, e assesi në këtë procedurë, sepse kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit ndalohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, dhe 27 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 999/22, datë 28.02.2024

Gjyqtari

Gent Bekeri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.